



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY



Dita 2: E martë, 29 Qershor: Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore

Trajnim On-Line “Programi për Përfshirjen
(Integrimin) e Qasjes së Bazuar në të Drejtat e
Njeriut (HRBA) dhe Barazisë Gjinore për OShC-të,
në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”



Si ndihemi sot?

Secili pjesëmarrës të përshkruajë me një fjalë se si ndihet sot (Psh, si ka filluar dita sot, ose si ndiheni në ditën e dytë të fillimit të trajnimit?)





Pop Quiz nr.2



Parimet themelore të HRBA-së

Parimet themelore të HRBA-së:

- Universaliteti & Patjetërsueshmëria;
- Barazia & Mosdiskriminimi;
- Përgjegjshmëria;
- Pjesëmarrja & Gjithëpërfshirja





Ndalimi i Diskriminimit

NENI 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Protokolli 12 i Konventës zgjeron gamën e të drejtave për të cilat ndalohet diskriminimi.



Elementët e diskriminimit

1. Trajtim i diferencuar dhe i pajustificuar
2. Me veprim ose mosveprim;
3. Reflektohet me përjashtim, kufizim ose preferenca.
4. I drejtpërdrejtë ose indirekt
5. I drejtohet një personi, grupi, anëtarëve të familjes ose të afërmve të tyre.
6. Bazohet në karakteristika individuale të cilat mund të jenë aktualisht ose të supozohen.



Seksi/Gjinia?

Termi ‘seks’ – I referohet ndryshimeve biologjike, të përcaktuara gjenetikiisht midis grave dhe burrave

Termi “Gjini” – i referohet sjelljeve apo veprimeve sociale ose kulturore që diferencojnë burrat nga gratë.

Gjinia nuk është diçka me të cilën kemi lindur apo diçka që kemi, por diçka që bëjmë apo realizojmë. Imagjinoni një djalë të vogël që ndjek me krenari

babanë e tij, mburret dhe nxjerr gjoksin, se ai po bën gjithçka që të jetë si babai i tij - të jetë burrë.

Sjelljet me bazë gjinore çojnë në kufizime se kush mund të kryejë çfarë, pa u ndëshkuar, diskriminuar apo intimiduar.

Në këtë pikë, gjinia dhe seksi bashkohen, ndërsa shoqëria përpiqet të pajtojë mënyrat e sjelljes me detyrat që imponon dallimi për shkak të seksit.



Shembuj (cili prej tyre është për shkak të seksit dhe cili prej shkak të gjinisë?)

- Gratë sjellin në jetë fëmijët.
- Vajzat janë të sjellshme, djemtë janë të ashpër.
- Në Evropë, shumica e shoferëve të kamionëve në distanca të gjata janë burra.
- Në radhët e punëtorëve bujqësorë indianë, gratë paguhen 40 - 60 % të pagës mashkullore.
- Zërat e djemve ndryshojnë gjatë periudhës së pubertetit , zëri i vajzave jo.
- Në Britani vajzat performojnë më mirë në shkollën fillore sesa djemtë.
- Gratë mund të ushqejnë foshnjat me gji, burrat mund të ushqejnë foshnjat me biberon.
- Burrat janë të ndjeshëm ndaj kancerit të prostatës, gratë nuk janë.

Një rast praktik nga Gjykata e Strasburgut (diskriminimi për shkak të seksit)

Jurčić kundër Kroacisë

Gjykata u shpreh në mbrojtjen nga diskriminimi të grave që i nënshtrohen trajtimit In-Vitro

Në vendimin e dt. 4 shkurt 2021, GJEDNJ dha një vendim bindës për çështjen e diskriminimit në bazë të seksit dhe shtatzënisë, të lidhur me të drejtën për të përfituar sigurimet shëndetësore publike.

Gjykata i dha të drejtë znj. Jurčić kur ajo pretendoi se ishte diskriminuar nga disa autoritete dhe gjykata kombëtare. Këto institucione, përkundër disa ankimeve nga kërkuesja, mbështeti nocionin se punësimi i saj kishte qenë fiktiv pasi ajo kishte qenë në trajtim për fekondim in vitro, kur u punësua në një pozicion në një kompani kroate. Ata pretenduan se motivi i saj i vetëm për të pranuar pozicionin ishte të merrte privilegje financiare në lidhje me statusin e personave që punonin gjatë shtatzënisë.



Vijon

Me këtë gjykim, Gjykata e Strasburgut solli një nivel të ri të mbrojtjes kundër diskriminimit në kontekstin e punësimit për gratë që i nënshtrohen trajtimeve të fertilitetit dhe të gjitha gratë shtatzëna në përgjithësi.

Gjykata hedh gjithashtu më shumë dritë mbi shkallën e mbrojtjes aktuale të seksit femër. Ajo e zgjeron atë, duke përfshirë kritikën ndaj ideologjisë seksiste që i dha shkas politikës së kundërshtuar nga aplikantja dhe rrezikun që ideologjia paraqet për rrezikshmërinë e stereotipeve gjinore.





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

HRBA në kontekstin e shoqërisë civile

Për diskutim

Çfarë është
integrimi i
të Drejtave
të Njeriut?

Po
Integrimi
Gjinor?



EU TACSO 3 project is funded by the European Union



Integrimi i të drejtave të njeriut

Nënkupton riorganizimin, përmirësimin, zhvillimin dhe vlerësimin e proceseve të politikave, në mënyrë që ato të përfshijnë një perspektivë të të drejtave të njeriut të në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga aktorët normalisht të përfshirë në politikëbërjen.

Integrimi i të drejtave të njeriut i referohet përfshirjes së kujdesshme të standardeve të të drejtave të njeriut në punën e organizatave.



Integrimi Gjnor

Integrimi sistematik i nevojave, interesave dhe përparësive përkatëse të burrave dhe grave në të gjitha politikat dhe aktivitetet e organizatës. Kjo hedh poshtë idenë se gjinia është një çështje e veçantë.

Kjo përfshin integrimin e një perspektive gjnore në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, rregulloreve dhe programeve të shpenzimeve, me qëllim promovimin e barazisë midis grave dhe burrave, dhe luftimin e diskriminimit.



Përfaqësimi Gjinor

PËRFAQËSIMI GJINOR përbën një nga dimensionet e integritit gjinor – dhe kërkon adresimin e çështjes së përfaqësimit të grave dhe burrave në fusha apo drejtime të ndryshme (psh shoqëria civile ka në disproporcion përfaqësimin e stafit femër në raport me atë mashkull, e njëjta situatë edhe në arsim, në politike situatë ka ardhur drejt përmirësimit - Kuotat gjinore në parlament dhe në Këshillat Bashkiakë).



Sfidat e integrimit gjinor për organizatat

Integrimi gjinor është përpjekja sistematike për të integruar shqetësimet gjinore në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe menaxhimit të programit, dhe gjithashtu në sistemin dhe procedurat organizative.

PNUD: “duke marrë parasysh shqetësimet e barazisë gjinore në të gjitha politikat, programet, veprimtaritë administrative dhe financiare dhe në procedurat organizative,

nevojitet një transformim i thellë organizativ. Konkretisht, integrimi gjinor kërkon që stafi të kuptojë plotësisht politikën përkatëse dhe kontekstin e saj dhe të ketë kapacitetin për ta zbatuar atë, në mënyrë që ata të mund të sjellin rezultatet e analizës së ndjeshme të politikës gjinore, në proceset thelbësore të vendimmarrjes së organizata.”


Pjesëmarrja

Parimi themelor dhe
fillestar i integritimit
është garantimi i
pjesëmarrjes!



Çfarë është pjesëmarrja?

- Kushdo ka të drejtë për pjesëmarrje aktive, të lirë dhe domethënëse në proceset e vendimmarrjes që do të ndikojnë në jetën shoqërore të këtij personi.
- Nga një perspektivë e HRBA, pjesëmarrja nuk është vetëm një mjet teknik i përdorur në planifikimin ose gjatë zbatimit të aktiviteteve, por është e drejtë dhe detyrë të përfshijë në mënyrë aktive të gjithë mbajtësit të të drejtave dhe bartësve të detyrave në të gjitha fazat e planifikimit, zbatimit, si dhe monitorimin dhe vlerësimin. Mundësimi i pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes është baza për qytetarinë aktive. Pjesëmarrja dhe përfshirja janë veçanërisht të rëndësishme për forcimin e grupeve më të rrezikuara, të marginalizuara, të përjashtuara dhe të padukshme në shoqëri.



Source: European Anti-poverty Network



Pop Quiz nr.3 – Deri në ç’masë ndiqni një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut në punën e organizatës tuaj, projektet dhe aktivitetet





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Pushim I shkurtër

15
min



terstock.com • 316127



EU TACSO 3 project is funded by the European Union



EU TACSO 3 Raporti Rajonal i Vlerësimit të Nevojave

Shumica dërmuese e OSHC-ve vendore dhe atyre që veprojnë në bazë (grassroots) kanë kapacitet të ulët në drejtim të krijimit të strukturave gjithëpërfshirëse të brendshme të orientuara drejt qasjes pjesëmarrëse gjithëpërfshirëse të HRBA-së. Shumicës së tyre i mungon perspektiva e barazisë gjinore, pjesëmarrja e të rinjve, përfshirja e personave me aftësi të kufizuara, pjesëmarrja e fëmijëve, e cila është thelbësore për strukturën gjithëpërfshirëse të organizatave, si dhe aktivitetet e tyre vëzhguese.

- Source: <http://tacso.eu/ep-content/uploads/2020/09/Regional-CS-Needs-Assessment-Report-2018-2019-final.pdf>



Cilat janë disa nga metodat që vlerësohen si efikase për të adresuar këto nevoja?

Rritja e ndërgjegjësimit mes OSHC-ve

Hartimi i politikave për të Drejtat e Njeriut dhe Politikave me bazë Gjinore

Integrimi i të drejtave të njeriut dhe gjinisë në sistemin e menaxhimit të programeve

Shmangia e stereotipeve brenda organizatës

Prioritarizimi i diversitetit duke krijuar lidhjet përkatëse me synim:

- a) Përcaktimin e grupeve që duhet të prioritarizohen dhe përse?
- b) Përse këto grupe meritojnë një vëmendje të veçantë?



Mënyrat se si organizatat mund të përfitojnë ekspertizë për çështjet gjinore

- Konsulentë për çështje gjinore
- Njësi të veçanta brenda organizatës për çështjet gjinore
- Pika kontakti për çështjet gjinore
- Rrjetëzime për çështjet gjinore
- Buletine informative apo faqe për çështje gjinore





Rast studimor 1 – mësimet

- Po zbatojme një nismë për integrimin dhe të drejtat e refugjateve.
- Refugjatët mund të kenë më shumë gjasa t'ja hapin derën, një ekipi me njerëz të sekseve të ndryshme për shkak të barrierave kulturore – kështu, dy burra mund të shihen më kërcënues, dhe dy gra mund të shihen si vulnerabël dhe të mos merren seriozisht.
- Strategjitë për të tërhequr gratë vullnetare në këto :
- Analizo se përse gratë tërhiqen nga vullnetarizmi
- Diskutojë me anëtarët e komunitetit lokal
- Vendos kontakte me gra vullnetare që të inkurajojnë gratë e tjera
- Rrit ndërgjegjësimin se përse gratë janë të nevojshme
- Reklamo avantazhet e vullnetarizmit
- Mbaj në konsideratë se disa gra mund të mos duan të kombinohen me burra, ose familjet e tyre mund të mos duan të punojnë me vullnetarë meshkuj, për shkak të traditës dhe kultures

Pyetje: Si do vepronit ju në këtë rast?

Integrimi i të Drejtave të Njeriut dhe Integrimi Gjinor: Tre hapa

Kushtet

Metodat
dhe Mjetet

Rezultatet

Sigurimi i kushteve (1)

Përgatitja: krijoni një plan për zbatimin e integritit gjinor, përcaktoni hapat dhe piketat kryesore, caktoni detyra dhe përgjegjësitë, zyrtarizoni dhe komunikoni planin.

Burimet njerëzore: duhet të keni në dispozicion burime të mjaftueshme; integrimi efektiv gjinor kërkon buxhet dhe kohë. Mendoni për burimet për ndërgjegjësimin dhe iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve. Përdorimi i ekspertizës (të jashtme) gjithashtu mund të merret në konsideratë.

Përfshirja e aktorëve (përfituesve): Kërkohet ndërlidhje e ngushtë me aktorët përgjegjës gjatë

gjithë ciklit të hartimit/zbatimit të politikave për të marrë dhe adresuar shqetësimet, pritjet dhe pikëpamjet e grupeve të synuara. Rekomandohet hedhja e bazave të qëndrueshme për përfshirjen e palëve të interesuara dhe konsultimet në procesin e politikave.



Sigurimi i kushteve(2)

Monitorimi dhe vlerësimi: krijo mekanizmat e ngarkuar me përgjegjësi, për të monitoruar dhe vlerësuar progresin. Parashikoni raportimin e rregullt dhe ndani rezultatet.

Ekspertiza Gjinore: kjo ekspertizë duhet të jetë e brendshme, në sajë të kapaciteteve të përftuara në forma të ndryshme (seminare, trajnime, etj) por mund të përdoret dhe ekspertiza e jashtme, në varësi të mundësive.





Metodat dhe Mjetet

Analiza Gjinore

Auditi Gjinor

Rritja e ndërgjegjësimit për Gjininë

Buxhetimi Gjinor

Trajnimi për barazinë gjinore ose me përfaqësim të barabartë gjinor

Vlerësimi Gjinor

Vlerësimi i Imapktit të Gjinisë

Indikatorët Gjinorë

Monitorimi Gjinor

Planifikimi Gjinor



Auditimi Gjinor

Auditimi gjinor është një mjet për të vlerësuar dhe kontrolluar institucionalizimin e barazisë gjinore në organizata, duke përfshirë politikat, programet, projektet dhe / ose ofrimin e shërbimeve, strukturat, procedurat dhe buxhetet e tyre.

Auditimet gjinore ndihmojnë organizatat të identifikojnë dhe kuptojnë modelet gjinore në përbërjen e tyre, strukturat, proceset, kulturën organizative dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, në hartimin dhe shpërndarjen e politikave dhe shërbimeve.



Analiza SWOT

- **Pikat e forta** (kapaciteti i stafit, materialet/burimet në dispozicion, etj)
- **Pikat e dobëta**
- **Mundësitë** (rritja e interesit të femrave në aktivitete të veçanta, ndryshimi i legjislacionit, etj).
- **Kërcënimet** (zakonet, mungesa e fondeve, etj)

SWOT Analysis

Strengths

Weaknesses

Opportunities

Threats

Rezultatet

Politikbërje më e mirë

Institucione që funksionojnë më mirë

Procese efikase me të mira



Përse është e rëndësishme të zhvillojmë projekte të orientuara ndaj ndjeshmërisë gjinore

1. Shqetësimet për çështjet gjinore përfshihen qartë në hartimin dhe zbatimin e propozimeve të projekteve.
2. Projektet që nuk marrin në konsideratë gjininë, mund të rrisin ngarkesën e grave dhe të kenë efekte negative tek fëmijët apo gjeneratat e reja.
3. Është e rëndësishme të zhvillojmë një objektiv të ndjeshëm gjinor (psh të ulim vulnerabilitetin e grave)
4. Aktivitetet duhet të planifikohen që të marrin në konsideratë faktorët që mund të kufizojnë pranimin/fitimin e projektit
5. **INDIKATORËT** për Gjininë – S.M.A.R.T.



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

2 grupe/2 tema

- 20 min për diskutim
- 5 minuta për prezantim
- Ndarja e roleve:
 - a) një person do masë kohën,
 - b) një do drejtojë diskutimet,
 - c) një do mbajë shënimet dhe pasqyrojë konkluzionet)





Të zhvillojmë një projekt të orientuar ndaj integritit gjinor Ndarja në Grupe dhe Detyrat

- 1. Grupi 1** zhvilloni një projekt që synon parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Bashkinë e Cerrikut.
- 2. Grupi 2** zhvilloni një projekt që synon të fuqizojë komunitetin lokal për të kundërshtuar ndërtimin e një impianti të përpunimit të plehrave, që ndot ambientin në një fshat të vogël në zonën e Fierit.

Të trija grupet do ti përgjigjen këtyre pyetjeve:

- Cilat janë hapat kryesore që do ndiqni për të orientuar drejt integritit gjinor projektin tuaj?
- Cilat janë mangësitë e organizatës që keni identifikuar që pengojnë realizimin e integritit gjinor? Si do ti kapërceni ato?
- Cilat janë disa nga aktivitetet që do të propozoni që kontribuojnë pozitivisht për integritin gjinor?
- Si do ti monitoroni dhe vlerësoni rezultatet e synuara, për indikatorët e lidhur me integritin gjinor?



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Pushim i shkurtër

15 min



EU TACSO 3 project is funded by the European Union





Pop Quiz nr.4





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Reflektime nga Pjesëmarrësit



EU TACSO 3 project is funded by the European Union





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Vlerësimi i trajnitimit dhe Konkluzionet Kryesore të ditës së dytë



EU TACSO 3 project is funded by the European Union

